

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS

01 Nr. 145

Prishtinë, më 9.05.2001

PRISHTINË GJYKATËN
KOMUNALE NË PRISHTINË

09-05-2001

GJYKATËS KOMUNALE NË PRISHTINË

PRISHTINË

Kreditori: Oda Ekonomike e Kosovës-Prishtinë, rr. „Nënë Terezë“, nr. 20.

Debitori: Barnatoret e Regjionit të Prishtinës, rr. „Nënë Terezë“, nr. 20.

(të cilat kanë qenë më parë në kuadër të Shtëpijës së Shëndetit - Prishtinë, dhe më vonë Enti i Barnatorëve të Prishtinës)

PRILUVENI DOKUMENTI
SUDUDARSTIN

PROPOZIM PËR EKZEKUTIM

për lirimin e lokaleve afariste

Në bazë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, XVI.C.Nr.807/94 të 17.11.1994, debitori është i obliguar që t'i lirojë nga sendet dhe njerëzit lokalet afariste të kreditorit që gjenden në Prishtinë, rr. „Nënë Terezë“, pjesa përdhese verilindore e ndërtesës së Odës, të cilat është duke i shfrytëzuar barnatorja e tretë, pa i siguruar strehim të nevojshëm, dhe të njejtat t'ia dorëzojë kreditorit në gjendje të rregullt, si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës.

Provë: fotokopja e aktgjykimit XVI. C-807/94, dhe
fotokopja e aktgjykimit, AC - 1823/95,

Me që debitori me dëshirë nuk vepron dhe nuk përfillë aktgjykimin e formës së prerë kreditori propozon që ajo gjykatë të merr

Aktvendim

Në bazë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Ekonomike - Prishtinë, XVI. C-807/94 të 17.11.1994, me propozimin e kreditorit Odës Ekonomike të Kosovës nga Prishtina, C A K T O H E T ekzekutimi kundër barnatoreve të regjionit të Prishtinës (që më parë sipas aktgjykimit kanë qenë në kuadër të Shtëpijës së Shëndetit - Prishtinë, barnatoret si njësi punuese, barnatoret e PËRBASHKËTA të Shtëpijës së Shëndetit „VETFARM“ të Prishtinës) me shpërngulje të dhunshme nga lokalet e kreditorit që gjendet në Prishtinë, rr. „N.Terezë“, nr. 20, Ndërtesa e Odës, pjesa përdhese ara verilindore me sipërfaqe prej 96 m2 dhe bodrumi nën te me 27 m2, në të cilat është vendosë barnatorja e tretë, me të gjitha sendet dhe njerëzit dhe t'ia dorëzojë kreditorit në shfrytëzim dhe posedim të qetë, t'ia paguajë shpenzimet e procedurës civile në kundërvlerën e valorizuar prej 372 din. Dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit është sa do të krijohen, krejt këto t'i paguajë në dobi të kreditorit.

Personi zyrtar, pas skadimit të afatit prej 8 ditësh nga dita e ekspedimit të këtij aktvendimi, do t'i largojë të gjitha sendet dhe njerëzit që gjenden në lokalet dhe bodrum dhe ato t'ia dorëzojnë në posedim kreditorit. Nëse debitori në afatin e caktuar nuk i kryen këto detyrime, personi zyrtar të punësuarit e debitorit do t'i largojë nga lokalet ndërsa sendet do t'i regjistrojë dhe dorëzojë personit të tretë në ruajtje, në llogari të debitorit.

Nëse debitori nuk i tërheq (merr) sendet në afatin e caktuar, të njejtat do të shiten, e dallimi nga çmimi i arritur në shitje, pas kompenzimit të shpenzimeve procedurale, shpenzimeve të ekzekutimit si dhe shpenzimeve për ruajtjen dhe shitjen e sendeve, do t'i paguhen debitorit.

Ekzekutimin do ta kryejë Gjykata Komunale në Prishtinë.



KRYETARI I ODËS
Ismail Kastrati